

VENDIM
Nr. 114, datë 19.5.2022

**MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR MBROJTJEN, PËRPUNIMIN,
RUAJTJEN DHE SIGURINË E TË DHËNAVE PERSONALE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; ligjit nr. 988, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar; si dhe nenit 16 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 3.9.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 668/1 prot., datë 13.5.2022, nga Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, “Mbi miratimin e rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”,

konstatoi se:

- Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, autoritetet publike kanë detyrim për të dhënë informacion publik, si dhe ruajtjen e të dhënave personale, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

- Në zbatim të detyrimeve ligjore të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, ka publikuar rregulloren tip për miratim nga autoritetet publike me synimin për të përcaktuar procedurat organizative e teknike, masat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të sigurisë, ruajtjes dhe administrimit të të dhënave personale nga autoritetet publike.

- Në mbështetje të neneve 16 dhe 46, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 20 dhe 41, pika 1, germa “e”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, Bordi i ERE-s, me vendim nr. 65, datë 26.3.2018, ka miratuar “Rregulloren për mbrojtjen e informacionit konfidencial”.

- Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, ERE ka përshtatur rregulloren tip të draftuar nga Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale (Komisioneri), duke ruajtur terminologjinë dhe rregullat tekniko-organizative për përpunimin e informacionit publik, sensitiv dhe sekret, sikurse të përkufizuar në ligjin nr. 9887/2008 dhe në rregulloren tip të publikuar nga Komisioneri.

- Rregullorja “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, në ERE, parashtrohet: dispozita të përgjithshme, objektin, kuadrin ligjor, qëllimin, përkufizimet e përdorura në rregullore, si dhe fushën e zbatimit të saj, bazuar në rregulloren tip të Komisionerit për miratim nga autoritetet publike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e “Rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve ngarkohet me nxjerrjen e urdhrave të nevojshëm për zbatimin e kësaj rregullore brenda 30 ditëve kalendarike.

3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë të gjitha strukturat organizative në ERE për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti